

## **10 Mesazhe kyc nga ETUCE**

### **Cfarë nevojitet për të përmirësuar Cilësinë e Arsimit në Europë**

Në kuadrin e inisiativës së Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI: “Të Bashkohemi për Arsim Cilësor - Arsim më Cilësor për një Botë më të Mirë” dhe të vendimeve të Konferencës së Komitetit Europian të Sindikatave të Arsimit, ETUCE, të vitit 2012, e cila identifikoi qartë nevojën për të vazhduar punën lidhur me shmangien e ndikimit të krizës mbi kushtet e punës dhe pagat e mësuesve, përfaqësuesit e organizatave anëtare të ETUCE, u takuan në një mbledhje të vecantë në Bruksel, më 23 tetor 2013, për të diskutuar lidhur me çështjen:

#### **Cfarë nevojitet për të përmirësuar cilësinë e arsimit në Europë?**

Duke patur parasysh se arsimi cilësor mbështetet në tri shtylla: Mësimdhënie Cilësore, Mjete Cilësore për Mësimdhënien dhe Ambjente Cilësore për Mësimdhënie dhe Nxënie, pjesëmarrësit në këtë takim ranë dakort për 10 mesazhet kyc, që u prezantuan për diskutim dhe adaptim Komitetit të ETUCE-s më 23-24 tetor 2013.

#### **1. Arsimimi Cilësor – një e drejtë bazë e njeriut dhe një e mirë publike**

Arsimimi cilësor është një e drejtë bazë e njeriut dhe një e mirë publike. Neni 26 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, thotë që “Cdo njeri ka të drejtë për arsimim” në të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë fëmijerininë e hershme, arsimin parashkollor, fillor dhe nentë vjecar, arsimin profesional dhe trajnimin, nevojat specifike për arsimim, arsimin e mesëm, të lartë dhe për të rritur. Vizioni i ETUCE për një arsim cilësor për të gjithë nxënësit, studentët dhe të rriturit në Europë, përcaktohet, jo vetëm në bazë të rezultateve të të nxënies, por, gjithashtu, edhe nga zhvillimi i plotë i individit dhe kontributit të tij/saj në një shoqëri demokratike.

#### **2. Vizioni i Sindikatave Europiane të Arsimit lidhur me Cilësinë e Arsimit**

Me synimin për të nxitur vizionin e sindikatave Europiane të arsimit për cilësinë e arsimit dhe për të mbështetur një arsimim me cilësi të lartë për të gjithë, si një nga shtyllat kryesore të një shoqërie të drejtë dhe demokratike, organizatat anëtare të ETUCE-s kërkojnë akses universal dhe të lirë për mësues cilësorë, mjete mësimore dhe burime moderne dhe ambjent të sigurtë e mbështetës për mësimdhënien dhe të nxënurit që marrin në konsideratë barazine gjinore dhe pa asnjë diskriminim.

### **3. Akses për të gjithë në arsimimin cilësor**

Duke synuar ndërgjegjësimin e publikut se aksesin në arsimin publik cilësor është themelor për çdo qytetar, organizatat anëtare të ETUCE-s konfirmojnë mbështetjen e tyre për iniciativën e EI: *Të Bashkohemi për një Arsim Cilësor*, dhe angazhohen për veprime të përbashkëta për një arsim cilësor, si edhe për trajnimin cilësor të mësuesve të rinj dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional.

### **4. Financimi i arsimit publik**

Në kontekstin e politikave të shtrënguara që pjesërisht ishin ndërmarrë për shkak të krizës ekonomike dhe janë zbatuar nga disa qeveri, të imponuara edhe nga Troika, organizatat anëtare të ETUCE-s kundërshtojnë ato politika që përcaktohen nga qendrime ideologjike dhe që janë kundër sigurimit të arsimit publik. Organizatat anëtare të ETUCE-s dënojnë rritjen e privatizimit të shërbimeve mjaft të domosdoshme për arsimin, nga ana e ndërmarrjeve që kanë interesa të lira dhe që kërcënojnë sigurimin e arsimit publik. ETUCE dhe organizatat anëtare të saj bëjnë thirrje për arsim publik pa pagese

### **5. Mundësi të barabarta dhe mobilitet social**

Arsimimi cilësor duhet të sigurohet në mënyrë të barabartë dhe jo mbi bazën e fitimit. Qeveritë kanë përgjegjësinë të sigurojnë burimet e duhura për të siguruar një sistem arsimor universalisht të aksesueshëm nëpërmjet taksimit progresiv dhe të drejtë. Rendësia e drejtësisë në taksat globale nuk kufizohet vetëm në forcimin e buxhetit të arsimit publik; por ai është, gjithashtu, i nevojshëm për një barazi më të madhe në oportunitete dhe mobilitete sociale.

### **6. Trajnimi i mësuesve cilësorë**

Duke pranuar rolin jetik të mësuesve dhe sindikatave në sistemin arsimor cilësor, organizatat anëtare të ETUCE-s theksojnë anagazhimin e mësuesve dhe sindikatave të tyre për të marrë përsipër drejtimin e përpjekjeve për të patur akses dhe cilësi për të gjithë studentët, si edhe një sistem arsimor në të mirë të publikut. Mësuesit janë burimi më i rëndësishëm i arsimit për studentët dhe një përcaktues jetik i cilësisë së arsimit; prandaj kontributet e tyre duhet të vlerësohen në mënyrë të barabartë. Mësuesit duhet të trajtohen

si profesionistë të respektuar dhe duhet t'u jepet trajnimi dhe mbështetja që u nevojitet.

## **7. Tërheqja për profesionin e mësuesit**

Sigurimi i stafit mësimdhënës të kualifikuar dhe të motivuar është çelësi për të siguruar cilësinë brenda sistemeve arsimore. Për rrjedhojë, ETUCE dhe organizatat e saj antare, luftojnë për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të mësuesve, kushte të mira pune dhe paga të mira, përfitime dhe pensione të mira, si për gratë edhe për burrat, akses në trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, burime të mira për mësimdhënie dhe nxënie si edhe ambjent pune të sigurtë. Këto janë parakushtet që do të ndihmojnë për ta bërë profesionin e mësimdhënies më tërheqës dhe për të inkurajuar më shumë njerëz që të ndër marrin këtë karrierë.

## **8. Sindikatat e mësuesve dhe instrumentat e dialogut social**

Duke e konsideruar dialogun social si një forcë shtytëse për reforma të suksesshme ekonomike dhe sociale, organizatat antare të ETUCE-s e venë theksin mbi potencialin e sindikatave për të ndërgjegjësuar antarët mbi pasojat e ndryshimeve ekonomike dhe sociale në sistemet sociale, arsimore dhe tregjet e punës. Sindikatat luajnë një rol kyç për sigurimin e kushteve të domosdoshme që do të stimulojnë krijimin e vendeve të punës, duke lehtësuar në mënyrë të dukshme rimëkëmbjen ekonomike, tregun e punës dhe përfshirjen sociale.

## **9. Përfshirja e sindikatave të arsimit në vendimet që lidhen direkt dhe indirekt me sektorin e arsimit**

Përfshirja e sindikatave të mësuesve në përpunimin dhe zbatimin e politikave që prekin direkt ose indirekt arsimin është thelbësore për sa i takon marrjes parasysh të pozicionit të tyre. Prandaj, organizatat antare të ETUCE-s kërkojnë që konsultimet e partnerëve socialë në nivel kombëtar, rajonal, arsimor institucional, duhet të bëhen në kohën e duhur dhe të jenë të motivuara duke lejuar analizat dhe propozimet e nevojshme të cilat duhet të perputhen me proceset e vendim marrjes. Është me rëndësi të vecantë që të forcohet dialogu social në nivel lokal që të përfshijë si mësuesit dhe drejtuesit e shkollës.

## **10. Konsultime koherente me partnerët sociale që synojnë progresin ekonomik dhe social**

Duke bërë thirrje për një process koherent dhe të respektuar konsultimesh të partnerëve socialë kombëtarë dhe/ose Europeanë, nga ana e qeverive në nivel kombëtar, dhe me Komisionin, Këshillin dhe Parlamentin në nivel European, organizatat antare të ETUCE-s kërkojnë që dimensionin social i Bashkimit Monetar European të kontribuojë për progresin ekonomik dhe social në BE. Kjo do të thotë që politikat duhet të jenë të tilla që të cojnë në progres ekonomik dhe social.

Bruksel, 23 tetor 2013